

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **TK-25-94-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Sistemi i burimeve njerezore dhe pagave**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	PBC SH.P.K.
NUI	810845985
Adresa	Rruga Bekim Fehmiu, 91
Vendi	Prishtina
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044467467
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Selmani
Adresa elektronike	bs@pbc.group
Data e parashtrimit të ankesës	26.03.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sistemi i burimeve njerezore dhe pagave

Njoftim për Kontratë: 05.02.2025

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 17.03.2025

Përgjigje në pyetje për sqarime shitesë: 20.02.2025

Përgjigje në pyetje për sqarime shitesë: 28.02.2025

Kërkesë për rishqyrtim – PBC Sh.p.k.: 14.03.2025

Pezullimi i aktivitetit nga AK: 14.03.2025

Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim - PBC Sh.P.K.: 17.03.2025

Kërkesë për rishqyrtim – Tretek Sh.p.k.: 20.03.2025

Pezullimi i aktivitetit nga AK: 20.03.2025

Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim – Tretek Sh.p.k.: 21.03.2025

Afati për dorëzimin e ofertave: 28.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Sipas nenit 108/A, kemi dorëzuar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoriteti

Kontraktues më datë 14.03.2025. Ndërsa më datë 17.03.2025, Autoriteti Kontraktues, ka nxjerrë vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Të dy këto dokumente i gjeni të bashkëngjitura.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenin 7.2 dhe 7.3 të Ligjit për Prokurim Publik;
Nenin 52.5 të Ligjit për Prokurim Publik;
Nenin 69 të Ligjit për Prokurim Publik;
Nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik;
Opinionin e KRPP-së me numër 11, të datës 09.06.2023.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

Bazuar në nenet 108 dhe 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), paraqesim këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK), i cili ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 14.03.2025, në lidhje me aktivitetin e prokurimit për "Zhvillimin e softuerit për Burime Njerëzore dhe Paga".

Vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, për faktin se nuk adreson drejt dhe në substancë pretendimet tona legjitime, të cilat prekin në mënyrë direkte konkurrencën e drejtë, proporcionalitetin e kërkesave, si dhe qartësinë dhe transparencën e kritereve të vlerësimit.

II. DISPOZITAT LIGJORE TË SHKELURA NGA AK

Kjo ankesë bazohet drejtpërdrejt në kërkesën për rishqyrtim, në të cilën kemi adresuar dy shkelje të qarta të Ligjit për Prokurim Publik:

1. Nenit 7, paragrafët 2 dhe 3 (mosdiskriminimi dhe barazia në trajtim);
2. Nenit 52.5 (kriteri i dhënies së kontratës – çmimi më i ulët).

Megjithatë, AK me Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, vazhdon të kryej edhe shkeljet e dispozitave ligjore si më poshtë:

3. Nenit 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale)
4. Nenit 108/A (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve)
5. Opinionin e KRPP-së me numër 11, të datës 09.06.2023

Dispozitat ligjore të lartpërmendura (e të cilat ishin shkelur me përpilimin e Dosjes së Tenderit) vazhdojnë të mbesin subjekt i shkeljeve thelbësore nga AK edhe me marrjen e Vendimit për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.

III. PRETENDIMET ANKIMORE

1. SHKELJE E NENIT 7, PARAGRAFËT 2 DHE 3 DHE NENIT 69 TË LPP – KUFIZIM I KONKURENCËS, DISKRIMINIM DHE INTERPRETIM I NGUSHTË I AFTËSISË TEKNIKE

a) AK ka vendosur një kriter që kufizon padrejtësisht pjesëmarrjen në aktivitetin e prokurimit, duke kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë përvojë në tre vitet e fundit në projekte identike Burimeve Njerëzore dhe Pagave ose të ngjashme në sektorë të ndryshëm, për atë kohë sa ato mbulojnë elementet thelbësore të zhvillimit të sistemeve për burime njerëzore dhe paga dhe arrijnë vlerën kumulative të kërkuar prej 150,000.00 euro në tre vitet e fundit.

Ky kriter është diskriminues dhe kufizon tejmas konkurrencën për faktin se:

- Përjashton në mënyrë arbitrare operatorët që kanë realizuar projekte identike por me vlerë më të ulët;
- Përjashton në mënyrë arbitrare operatorët që kanë përvojë të ngjashme në zhvillim softuerik me kompleksitet të njëjtë në fusha të tjera;
- Përjashton në mënyrë arbitrare operatorët që kanë përvojë të vlefshme, por jo identike;

Elaborimi për këto përjashtime është si më poshtë:

AK, në Vendimin për Refuzim, e justifikon lajthitshëm dhe me dinakëri këtë si "kriter profesional dhe teknik" sipas nenit 51, por harron se çdo kriter i tillë duhet të jetë proporcional dhe jo kufizues, sipas nenit 7 të LPP.

Për më tepër, ky kriter bie ndesh edhe me nenin 69 të LPP-së, i cili parasheh që autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë "dëshmi për kontrata të njëjta ose të ngjashme", jo domosdoshmërisht identike dhe jo të kufizuara në një prag financiar arbitrar.

Për të mos u mjaftuar me kaq, AK këtë kriter e vendos po ashtu në kundërshtim me KRPP-në, specifikisht me Opinionin nr. 11 të datës 09.06.2023. Pra, haptazi dhe dinakërisht AK del kundër organit i cili është përgjegjës për secilin zhvillim dhe funksionim të prokurimit publik në Kosovë. e cili ndër të tjerash, në Opinionin e lartpërmendur kishte cituar si në vijim:

citat

“....Shembull: Lënda e Kontratës “Furnizim me mollë”. Nëse AK kërkon si dëshmi ” Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro”. Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatorët ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).”

“Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t’i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para”

“....Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik”

mbarim citati

Pra, duke marrë parasysh Opinionin më lart, e në anën tjetër duke marrë parasyshë përgjigjen e AK-së në Sqarimet Shtesë: “...dëshmojë përvojë ne tre vitet e fundit në projekte identike Burimeve Njerëzore dhe Pagave ose të ngjashme në sektorë të ndryshëm, për aq kohë sa ato mbulojnë elementet thelbësore të zhvillimit të sistemeve për burime njerëzore dhe paga”, shohim se AK ka vepruar me dinakëri për faktin se ka deklaruar se kinse pranohen dëshmi të njëjta apo të ngjashme, të cilat më pastaj, ato

dëshmi i ka orientuar specifikuar decidivisht dhe taksativisht vetëm në Zhvillim Softuerik për Burime Njerëzore dhe në Paga. Pra, AK realisht kërkon dëshmi për kontrata të njëjta, e jo dëshmi për kontrata të ngjashme të cilat mund ti përmbushnin lehtësisht kërkesat e AK-së sipas kësaj Dosjeje të Tenderit.

b) AK, po ashtu me këtë kriter, në mënyrë arbitrare, dinakërore dhe padrejtësisht, kufizon konkurrencën dhe kryen favorizime për shkak që:

- AK përjashton operatorët që kanë implementuar kontrata identike por me vlerë më të ulët se 150,000 € në tre vitet e fundit. Ky përjashtim bëhet në dy forma:
 - Forma e parë: vlera 150,000.00EUR sipas AK është për përshtatshmëri të OE në këtë projekt. Në anën tjetër, AK si kriter për vlerësim të përshtatshmërisë konsideron se duhet të jenë njohjet e proceseve specifike të burimeve njerëzore dhe pagave, kompleksiteti i integritetit me sistemet ekzistuese, kohëzgjatja e zbatimit nga OE dhe përvoja e drejtpërdrejtë në këtë sektor.
 - Forma e dytë: AK nuk trajton dhe shqyrton fare kërkesën tonë për largimin e vlerës financiare. Kjo bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 108/A.
- AK përjashton operatorët që kanë përvojë në sisteme të ngjashme (me module për HR, paga, menaxhim të stafit etj.) por që nuk mbajnë emërtimin specifik “HR dhe Paga”.

2. SHKELJE E NENIT 52.5 TË LPP – PËRFSHIRJA E ELEMENTIT TË VLERËSIMIT TEKNIK NË KUSHTET E KRITERIT “ÇMIMI MË I ULËT”

Në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1, kërkohet përshkrimi i zgjidhjes teknike, duke përfshirë teknologjinë, arkitekturën dhe metodologjinë e implementimit. AK po ashtu thekëson se ky përshkrim do të ndihmojë në vlerësim të mundësive të OE për të ofruar zgjidhjen. Pra, deklaron decidivisht se kjo do të ndihmojë në vlerësim të mundësive të OE për të ofruar zgjidhje.

Edhe pse AK në Vendimin për Refuzimin e Kërkesës tonë pretendon se kjo nuk do të vlerësohet dhe këtë e quan si verifikim formal të ofertës (p.s., asnjë rregullativë ligjore e prokurimit publik nuk e përmend verifikimin formal si veprim që ndërmerr AK), vetë kërkesa për përshkrim të tillë është e panevojshme nëse nuk ka funksion vlerësues, dhe krijon hapësirë për vlerësim subjektiv – gjë që është e ndaluar nga neni 52.5 i LPP-së kur kriteri është vetëm “çmimi më i ulët”, e po ashtu bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së ngaqë ky Aneksi i përshtatet një OE-je të favorizuar ku ne të tjerët diskriminohemi haptazi.

Për këto shkaqe dhe arsye i propozojmë OSHP-së që pas shqyrtimit të ankesës sonë, të marrë VENDIM:

1. APROVOHET TËRËSISHT si e bazuar Ankesa e OE PBC SH.P.K.

2. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues që të:

- Modifikojë kriterin për dëshmimin e përvojës së mëparshme, duke mundësuar që OE-të të ofrojnë kontrata të njëjta pa kufizim të vlerës financiare, ose kontrata të ngjashme sipas kodit të përcaktuar në FPP, në vlerë kumulative financiare prej 150,000.00 euro;
- Përcaktojë në mënyrë të qartë, objektive dhe ligjore elementet që mund të kërkojnë si kritere për vlerësim, duke respektuar nenin 52.5 të LPP-së;
- Harmonizojë Dosjen e Tenderit me nenin 69 të LPP-së, duke garantuar një konkurrencë të drejtë dhe duke siguruar që përjashtohen vetëm operatorët ekonomikë joadekuatë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale do të përcaktohen pas një ekspertize financiare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*